



Z. Maldi Dema, Drejtor në Drejtorinë e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore është emëruar pranë Institutit të Statistikave në vitin 2007 dhe ka mbuluar detyrën e drejtuesit të strukturave përgjegjëse për çështjet e legjislacionit për statistikat zyrtare, administrimit të përgjithshëm, prokurimeve, menaxhimin e burimeve njerëzore e financiare etj.

Z. Dema është diplomuar “Jurist” në vitin 1995 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Më pas ka kryer studimin pasuniversitar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në degën “Marketing i avancuar” dhe, në vitin 2011, ka kryer studimet post-master “Leadership-Menaxhim karriere” (Master Ekzekutiv sipas legjislacionit për arsimin e lartë) pranë Universitetit Evropian të Tiranës.

Në vitin 2017, Z. Dema ka kryer stazhin 5-mujor pranë Eurostatit, gjë që ka ndikuar në rritjen e aftësive profesionale në fushën e koordinimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe përafrimit me *acquis communautaire*.

Në vitin 2020, Z. Dema u zgjodh Zëvendëskryetar i Bordit Drejtues.

Nga viti 2017, është pjesë e Task Forcës së udhëhequr nga UNECE për hartimin e “Guidance on Modernizing Statistical Legislation”. Gjithashtu është pjesë e Grupit të Ekspertëve UNECE për Modernizimin e Legjislacionit Statistikor për pasurimin më tej të këtij manuali.

Gjatë periudhës së punësimit pranë Institutit të Statistikave, përveç anës administrative, Z. Dema është angazhuar edhe me koordinimin e proceseve të integritit evropian për Kapitullin 18 “Statistikat”, me përgatitjen e kuadrit ligjor në fushën e prodhimit statistikor për përafrimin me standardet e *acquis* si dhe me përgatitjen e projekt-Programit pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare e Planit Vjetor për zbatimin e tij.